



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2018:029339

Datë: 15.07.2022

Numri i dokumentit: 03232500

P.nr.1018/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit N.M nga Gjilani për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 i KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1442/2016 të datës 26.08.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik në të cilin kanë prezantuar prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu dhe i pandehuri N.M, me datë 15.07.2022 mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri N.M nga babai N dhe nëna M, e lindur H i lindur me datë ...në fshatin ...Komuna e Gjilanit ndërsa me vendbanim në Gjilan, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal...,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 29.07.2016, rreth orës 08:45 minuta, në Gjilan, në rrugën “R...”, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete duke përdorur metodën e mashtrimit sjell në lajthim të dëmtuarin B.R, në atë mënyrë që shkon në shtëpinë e të dëmtuarit duke u prezantuar si fqinjë i tij dhe nga i njejtë kërkon hua shumë prej 50 € kinse djalin e kishte të sëmurë dhe me këtë rast i pandehuri merr nga i dëmtuari shumë e parave dhe largohet nga shtëpia e të dëmtuarit duke e shtytë të dëmtuarin të veprojë në dëm të pasurisë së tij e duke krijuar dobi pasurore për vete në shumë prej 50 €.

-Me çka ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-ës të pandehurin e lartcekur:

### E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehurin në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale.

Obligohet i pandehuri që në emër të kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit B.R t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar me veprë penale në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

### ARSYETIM

#### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm me datë 30.08.2016 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1442/2016 kundër të pandehurit N.M nga Gjilani për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Më datë 15.07.2022 në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu dhe i pandehuri N.M për të cilin nga ana e gjykatës ishte lëshuar letërrreshtim. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës lëndore nga ana e prokurores së shtetit i pandehuri i lartcekur ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e saj, me ç' rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në bazë të nenit 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

#### 2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimi fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehuri, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar

ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmbajnë aktakuzat siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2016-CA-1238 i datës 29.07.2016, deklarata e të pandehurit N.M, deklarata e të dëmtuarit B.R, deklarata e dëshmitarit A.R, raporti i zyrtares policore si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri N.M nga Gjilani ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 paragrafi 1 i KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës ku mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale në të cilën përfshihet fakti se i njëjti ka qenë plotësisht i përgjegjshëm për veprimet e veta sepse në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka lënguar nga ndonjë sëmundje mendore apo ndonjë sëmundje tjetër, faktin se i njëjti ka paraqit një shkallë të lartë të vetëdijes dhe dëshirës për ta kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor si dhe faktin se i njëjti këtë vepër e ka kryer me dashje dhe atë direkte, gjykata pati parasysh edhe sjelljen e mëparshme të pandehurit ku nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës del se për të pandehurin është hera e parë që bie ndesh me ligjin, po ashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh edhe pranimin e fajit nga ana e të pandehurit. Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 74 të KPRK-ës ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata mori pranimin e fajësisë për kryerjen e veprës penale në një fazë të hershme të procedurës penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, faktin se i njëjti ka kërkuar falje për këto veprime, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera si dhe gatishmërinë e të njëjtit që të dëmtuarit t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të pandehurit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës del i pandehuri këtë vepër penale e ka kryer me dashje dhe atë direkte duke e ditur se me veprimet e tij do të shkaktohet pasoja e ndaluar përkatësisht të dëmtuarit do ti shkaktohet dëm pasurore mirëpo përkundër kësaj i njëjti duke e

sjell të dëmtuarin në lajthim të njejtin e mashtron dhe e shtyn të veprjë në dëm të pasurisë së tij ashtu siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 5.Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës është cekur vlera e dëmit të shkaktuar me veprë penale gjykata e ka obliguar të pandehurin e lartcekur që të dëmtuarit B.R t'ia kompensoj dëmin në shumë prej 50 € në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

#### 6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.1018/2016 me datë 15.07.2022

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermahaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjiilan.